



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.631/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit NSH “M...E... B.I. me numër identifikues 810898231 me seli në Prishtinë, dhe Anesi shpk me numër identifikues 810010207 me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve SCLR Partners shpk në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik në Prishtinë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësve, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.51/2024 të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësve NSH “M...E... B.I. me numër identifikues 810898231 me seli në Prishtinë, dhe Anesi shpk me numër identifikues 810010207 me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.51/24 i datës 26.01.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësve NSH “M...E... B.I. me numër identifikues 810898231 me seli në Prishtinë, dhe Anesi shpk me numër identifikues 810010207 me seli në Prishtinë, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit OSHP: 2023/0853 datës 29.12.2023, deri në vendim përfundimtar të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësve, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të procedurës, dhe aplikimin e gabuar të drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet si i pabazuar aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.51/24 i datës 26.01.2024 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, ose të aprovohet në tërsi si e bazuar ankesa e paditësve, të Ndryshohet aktvendimi i atakuar, ashtu që të Aprovohet në tërsi propozimi i paditësve për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP 2023/0853 datës 29.12.2023, Shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurës OSHP 2023/0853 datës 29.12.2023 deri në vendosjen përfundimtare sipas kërkesëpadsisë me aktgjykim meritore.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësve, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësve, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP 2023/0853 datës 29.12.2023 i nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me seli në Prishtinë, ka gjetur se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të kontestuar, ptë ëprcaktuara në nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, asi që paditësit nuk e kanë bërë të besueshme kërkesën e tyre lidhur me dëmin e pa-riparueshëm mbi ndonjë bazë reale sepse nuk ka arrit që të argumentoj të njëjtin me prova. Po ashtu gjykata vlerësoi të pabazuara pretendimet lidhur me kushtet e tjera se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe që shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk do ti shkaktonte dëm të madh palës kundërshtare.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që: *shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP:2023/0853 datës 29.12.2023 i nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me seli në Prishtinë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesve, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paditurës. Meqë në këtë rast paditësit, në ankesën e ushtruar nuk kanë bërë të besueshme pretendimet e tyre, se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së, prandaj, pretendimet ankimore se me lejimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës, paditësve i shkaktohet dëm material sepse iu pamundësohet fitimi dhe realizimi i kësaj kontrate duke qenë si operator ekonomik të përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë, Kolegji i vlerësoi këto pretendime si të pabazuara dhe të pa argumentuara. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar i Dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Pretendimet ankimore për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, Kolegji i vlerësoi si tërësisht të mbështetura në deklaratat të paargumentuara, dhe në këtë rast paditësit nuk kanë paraqit dëshmi se si ka ardhur deri të dëmi i shkakuar me ekzekutimin e vendimit të paditurës, ashtu që ekzekutimi i vendimit kontestues do t,iu shkaktonte dëm të riparueshëm. Pretendimet tjera ankimore sa i përket përgjegjësisë dhe ofrimit të çmimeve nga operatorët ekonomik që kanë marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit me titull “mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët nacionale dhe rajonale të Kosovës” për vitet 2023-2024-2025-2026 nr.prokurimit 205-23-7625-2-1-1 nga autoriteti kontraktues Ministri e Infrastrukturës, Kolegji i vlerësoi si tërësisht të mbështetura në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata e shkallës së parë, do të vendosë në mënyrë meritorë pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Kolegji pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm, se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, apo kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të propozimit të paditësve, me të cilën kanë kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP 2023/0853 datës 29.12.2023 i nxjerr nga i padituri Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik me seli në Prishtinë, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor përkitazi me padinë e paditësit, Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.631/24 datë 12.03.2024

Kryetari i Kolegjit
Krenar Berisha